

**Njoftim për përqendrim me të cilin Cinesite Media Holdings Limited, Londër, Mbretëria e Bashkuar, do të fitoj kontroll mbi Shoqërinë e prodhimit të filmit FHZH Cinesite SHPK Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut**

**(lënda nr. 08-19/2022)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë "nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më datë 21.01.2022, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin shoqëria **Cinesite Media Holdings Limited** me seli në Medius Haus Sheraton strit, Londër, Mbretëria e Bashkuar, B1F 8BH. Ka për qëllim nëpërmjet shoqërisë së saj të varur **Komino Media Ltd**, me seli të regjistruar në Medius Haus 2 Sheraton strit Londër, B1F 8BH, Mbretëria e Bashkuar, të fitoj kontroll indirekt ndaj **Shoqërisë së prodhimit të filmit FHZH Cinesite SHPK Shkup** me seli në Todor Aleksandrov 71/2-2, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut.

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktiviteti i tyre i biznesit :**

**Cinesite Media Holdings Limited** është një studio për përmbajtje argëtuese dixhitale që ofron shërbime të efekteve vizuale filmike ose krijimin dhe realizimin e të gjithë filmave të animuar.

**Komino Media Ltd.** është aktive në ofrimin e aktiviteteve post-prodhimit të filmit, videove dhe programit televiziv.

**FHZH Cinesite** është një shoqëri e sapo themeluar , veprimtaria e regjistruar e së cilës është kryerja e aktiviteteve të prodhimit filmik, videove dhe programeve televizive.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

27.01.2022

Shkup